

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

17.01.2023
Ora 12:37

RENDI I DITËS

*Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25,
26 dhe 27*

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaaj, Z. Erdal Mema, Znj. Kejsa Bici.
- **Të tjerë:** Z. Mustafa Gjinaj, Z. Aristotel Petro, Z. Sildi Hodo
Z. Lutfi Meçka, KRIIK

Z. L. Braho: Përshëndetje, sot si fillim në orën 12:30 kishim lënë shqyrtimin administrativ për kërkesat ankimore 12, 13 dhe 14 që i takojnë OSHMA-ve: Mat Television, Club TV dhe A2 CNN. Duke qenë se këto janë bashkuar në një dhe po ashtu meqenëse pas këtyre tre kërkesave ankimore janë paraqitur edhe një sërë kërkesash ankimore për të cilat nuk u zhvillua seanca e shqyrtimit paraprak, si fillim do të bëjmë njëherë shtyrtimin paraprak për secilën nga kërkesat vijuese dhe në rastin hipotetik që ato do të pranohen për shqyrtim, do të gjykohen së bashku me këto tre kërkesat e para. Kështu që si fillim do të shtyrtojmë në zbatim të nenit 129 kërkesën e OSHMA-së Tv Kukës që është kërkesa e depozituar në datë 5 janar 2023. Që supozohet të jetë kërkesa numër 1 Ylli? Kanë filluar nga fillimi këto?

Z. Y. Merkaaj: Po!

Z. L. Braho: Kërkesa ankimore numër 1. Ka përfaqësues nga televizioni Kukësit?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. L. Braho: Kush jeni ju lutem mund të prezantoheni?

Z. L. Meçka : Lutfi Meçka, Televizioni Kukësit.

Z. L. Braho: Dakord. Ylli në lidhje me elementët e formës dhe të përmbajtjes së kësaj kërkesë ankimore?

Z. Y. Merkaj: Nga shqyrtimi i mëparshëm i kësaj kërkesë ankimore konstatohet se, është në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor pasi ka elementë të formës dhe të përmbajtjes që parashikon Kodi Zgjedhor dhe këto dy nene specifikisht, faleminderit.

Z. L. Braho: Dakord, vazhdojmë me kërkesën tjetër dhe pastaj të gjithë vendimet për secilën. Për subjektin Era Digital ka përfaqësues?

Z. M. Gjinaj: Mustafa Gjinaj me autorizim të kryetarit të shoqatës, për një seri televizioneve e kam dorëzuar edhe autorizimin aty për Era Digital dhe Best Tv, kur të vijë radha.

Z. L. Braho: Pra, Era Digital është shoqatë? Është subjekt shoqatë?

Z. M. Gjinaj: Është subjekt i shoqatës. Një pjesë e televizioneve të shoqatës që kam vendosur në listë dhe ja kam drejtuar Komisionerit janë të gjitha pjesë e

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

shoqatës. Një kopje të autorizimit e kam dorëzuar në sekretariat dhe një kopje e kam këtu.

Z. L. Braho: Zoti Ylli në lidhje me elementët e kësaj kërkesë duke qenë se është edhe shoqatë, nuk e di, çfarë qëndrimi keni ju?

Z. Y. Merhaj: Po edhe kjo ankesë i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 126, pasi ka formën dhe përmbajtjen e një ankimi ku është kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që është kompetencë e KAS-it. Kështu që i plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes.

Z. L. Braho: Legjitimohet ankuesi në këtë rast si shoqatë? Kush është subjekti që ka marrë dënimin administrativ nga Komisioneri?

Z. Y. Merhaj: Andrea Asllani, Era Digital e ka marrë gjobën.

Z. L. Braho: Për subjektin Tv Apollonia, ka përfaqësues?

Z. M. Gjinaj: Edhe për Tv Apolloninë e njëjta gjë .

Z. L. Braho: Jeni ju, me autorizim?

Z. M. Gjinaj: Po, nga pronari i shoqatës. Është një kopje aty e depozituar.

Z. L. Braho: Mund ti shohim pak këto autorizimet në lidhje me këto subjektet? Për TV Apollonia zoti Ylli, i plotëson elementët e formës dhe të përmbajtjes?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. Y. Merkaj: Po, është në përputhje me nenin 126, 130 të Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Televizioni Saranda, kërkesa tjetër ankimore.

Administratori Saranda Televizion: Këtu.

Z. L. Braho: Mund të prezantoheni?

Administratori Saranda Televizion: Unë jam administrator i Saranda Televizion.

Z. L. Braho: Zoti Ylli, televizioni Saranda i plotëson kriteret?

Z. Y. Merkaj: Po edhe televizioni Saranda i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Z. L. Braho: Faleminderit! Tv Koploku ka përfaqësues?

Z. M. Gjinaj: Edhe për Tv Koplkun unë.

Z. Y. Merkaj: Ja dhe autorizimi.

Z. L. Braho: Faleminderit Zoti Ylli po Tv Koplku i plotëson kriteret?

Z. Y. Merkaj: Po është në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht nenin 126 dhe 130.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Faleminderit! Tv Best channel?

Z. M. Gjinaj: E njejta gjë, me të njëjtin administrator jam Andrea Asllani.

Z. L. Braho: Ylli për këtë subjekt?

Z. Y. Merkaj: Po edhe ky subjekt e ka dorëzuar ankimin sipas përcaktimeve të dispozitave të Kodit.

Z. L. Braho: Glob TV?

Z. M. Gjinaj: E njejta gjë.

Z. L. Braho: Ylli për këtë subjekt, i plotëson?

Z. Y. Merkaj: Po edhe ky subjekt i plotëson.

Z. L. Braho: AMG 2000?

Z. A. Petro: Po, Aristotel Petro. Njëkohësisht kemi edhe Mustafain këtu, i shoqatës së mediave.

Z. L. Braho: Ylli i plotëson AMG 2000 kriteret?

Z. Y. Merkaj: Po, pas shqyrtimit paraprak të KAS përcakton se i plotëson kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.17.01.2023

Z. L. Braho: Subjekti tjetër është “Shoqata e Transmetuesve Radioteleviziv Kabllor Valor”.

Z. M. Gjinaj: Ky pra që diskutuam deri më tani.

Z. L. Braho: Ka dënim administrativ për këtë shoqatë?

Z. M. Gjinaj: Nuk ka shoqata.

Z. L. Braho: Pse ka bërë ankim shoqata?

Z. M. Gjinaj: Shoqata i ka bërë një letër Komisionerit për të gjitha problematikat që ka dhe i ka bërë në mbështetje të Kodit të Procedurës Administrative që i takon për çdo ankesë që ka secili.

Z. L. Braho: Tani këtu jemi në mbështetje të Kodit Zgjedhor, pra kërkesat ankimore depozitohen në zbatim të nenit 124, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Z. Ylli kjo shoqatë i plotëson kriteret?

Z. Y. Merkaç: Duke qenë se kjo shoqatë i ka bërë të gjitha ankimet veç e veç kjo është një përmbledhje e të gjitha ankimeve. Kështuqë nuk ka vlerë të kalojë si ankesë për shqyrtim.

Z. L. Braho: Po Tv Klaudio që është edhe i fundit i plotëson kriteret?

Z. Y. Merkaç: Po edhe ky ankim i plotëson kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Më falni është dhe një kërkesë ankimore numër 19, Tv Berati, të cilën nuk e lexuam.

Z. L. Braho: Nuk e kam këtu tek lista. Po, ka përfaqësues?

Z. M. Gjinaj: Jam unë për.

Z. L. Braho: Po. I plotëson kriteret Tv Berati?

Z. Y. Merkaj: Tv Berati është në të njëjtat kushte me kërkesat e mëparshme ankimore.

Z. L. Braho: Ka ndonjë kërkesë tjetër ankimore në lidhje me këtë çështje?

Z. Y. Merkaj: Jo, kjo është e fundit.

Z. L. Braho: Atëherë pesë minuta pushim sa të marrim një vendim në lidhje me faktin nëqoftëse do të kalohen për shqyrtim administrativ këto kërkesa apo jo, dhe më tej do të vijojmë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

Rifillon seanca

Ora 12:56

Z. L. Braho: Atëherë riçelim seancën! Pasi u konsultuam në vend në lidhje me kërkesat ankimore që u shtruan për verifikim të plotësimit të formës dhe përmbajtjes në zbatim të nenit 129 të Kodit Zgjedhor KAS vendosi:

- Pranimin e kërkesës numër 17 për shqyrtim. Kërkesë e televizionit Klaudio, të depozituar në KQZ datë 20.12.2022.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 18 të Televizionit Saranda e depozituar datë 21.12.2022.
- Pranimin e kërkesës ankimore numër 19 të shoqërisë TV Berati sh.p.k e depozituar ne KQZ datë 23.12.2022.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 20 që përket subjektit Glob Tv që është depozituar në KQZ në datë 27.12.2022.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 21 që i përket subjektit AMG 2000 që është depozituar në KQZ në date 30.12.2022.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 22 që i përket subjektit Tv Apollon që është depozituar në KQZ në date 06.01.2023.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 23 që i përket subjektit Tv Koplik që është depozituar në KQZ në date 06.01.2023.
- Mos pranimin e kërkesës numër 24 që i përket Shoqatës së Transmetuesve Radioteleviziv Kabllor Valor për shkak të mungesës së emelentëve të përcaktuar në nenin 130 të Kodit Zgjedhor. Konkretiksht më lidhje me legjitimitetin e këtij subjekti për të depozituar ankim për aq kohë sa nuk ka një dënim administrativ për

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.17.01.2023*

- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 25 që i përket subjektit Tv Best që është depozituar në KQZ në date 06.01.2023.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 26 që i përket subjektit Era Digital sh.p.k që është depozituar në KQZ në datë 06.01.2023.
- Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore numër 27 që i përket subjektit televizioni Kukës Sha që është depozituar në KQZ në date 05.01.2023 e cila është dhe kërkesa e fundit.

Në zbatim të nenit 132 të Kodit Zgjedhor për të gjitha kërkesat ankimore për të cilat u pranua kalimi i tyre për shqyrtim, KAS vendosi bashkimin e tyre dhe shqyrtimin së bashku me kërkesat ankimore që i përkasin subjekteve Mat Televizion, Club Tv dhe A2 CNN. Shqyrtim ky që do të vijojë pas 5 minutash.

Vendimi nr. 2, 3

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

